



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

VENDIM

Nr. 86/2019

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 90/2017
“PËR CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME
TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 2, e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Deputeti Nikolin Staka largohet nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat dhe caktohet anëtar në Komisionin për Integrimin Europian.

2. Deputetja Suzana Topi largohet nga Komisioni për Integrimin Europian dhe caktohet anëtare në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

3. Deputeti Ramazan Gjuzi caktohet anëtar në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 18.7.2019